

Në bazë të nenit 3, paragrafit 1, paragrafit 20 dhe nenit 13 të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/ 16 dhe 64/18), në lidhje me nenin 6 dhe nenin 15 pika 1.5. nga Rregullorja për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe përcaktimit të kompensimit autorial dhe të kompensimeve për shërbimet e tjera të Qendrës Shtetërore të Provimeve nr. 01-440/3 nga 28.12.2022 dhe nr. 01-176/3 nga 1.3.2023, u.d. drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve solli:

KONKURS PUBLIK
për përzgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm-vlerësues

Qendra Shtetërore e Provimeve shpall konkurs publik për përzgjedhje të **bashkëpunëtorëve të jashtëm-vlerësues të testeve nga pjesa eksterne e maturës shtetërore në vitin shkollor 2022/2023**, për lëndët:

- **Gjuhë Maqedonase dhe Letërsi;**
- **Gjuhë Shqipe dhe Letërsi;**
- **Gjuhë Turke dhe Letërsi**
- **Gjuhë Angleze;**
- **Gjuhë Frënge;**
- **Gjuhë Gjermane;**
- **Gjuhë Ruse;**
- **Matematikë (në gjuhën mësimore maqedonase);**
- **Matematikë (në gjuhën mësimore shqipe);**
- **Matematikë (në gjuhën mësimore turke);**
- **Estetikë / Filozofi (në gjuhën mësimore maqedonase);**
- **Estetikë / Filozofi (në gjuhën mësimore shqipe).**

Vlerësimi i testeve do të realizohet në Shkup, në periudhën nga **9.6.2023 deri më 27.6.2023**.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë kryer të paktën studime akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse;
- të jenë nga radha e mësimdhënësve të lëndës arsimore përkatëse në shkollat e mesme në RMV;
- të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në mësimdhënie.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje të plotësuar (formulari i vendosur në këto ueb-faqe www.matura.gov.mk dhe www.dic.edu.m);
- kopje të certifikatës/diplomës për arsimin e lartë adekuat;
- vërtetim në origjinal të marrëdhënies së rregullt të punës dhe të përvojës adekuate të punës prej të paktën 3 vjetësh si mësimdhënës nga lënda përkatëse të lëshuar nga shkollat e mesme në RMV.

Aplikimet me dokumentacionin e pakompletuar dhe jovalid dhe aplikimet e dorëzuara jashtë afatit kohor nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e mësipërme do të thirren në trajnim dhe do të testohen, pas kësaj do të pasojë përzgjedhja përfundimtare.

Kandidatët të cilët nuk marrin pjesë në trajnim nuk do të merren parasysh në procedurën e mëtejme.

Konkursi zgjat deri më **18.4.2023**.

Aplikimi me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet VETËM PËRMES POSTËS pranë Qendrës Shtetërore të Provimeve me adresë rr. "Vasil Gjorgov" p.n., 1000 Shkup, me shënimin ***për konkursin publik dhe lëndën për të cilën kandidati aplikon.***

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE